



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 13.12.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tiera Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Feim Osmani (LVV), Petrit Reçica (LVV), Violeta Salihu (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti, (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

Munguan: Berat Lahu (LVV), Edmond Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Dasmor Durmishi (LDK), Sami Salihu (LDK) dhe Fiknete Bejta (LDK).

Të pranishëm ishin edhe: Alban Zogaj - nënkryetar, Jehona Lushaku-Sadriu - nënkryetare, Valbona Ajeti - drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci - drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donjeta Dragusha - drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë, përfaqësues të OSBE-së dhe të medieeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Alban Zogaj, nënkryetar: - propozoi që në rend të ditës të hyjë pika: “Formimi i Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr. 465-25/85, të dt. 8 korrik 1985”.

Gëzim Sveçla: - propozoi që në rend të ditës të hyjë pika: “Diskutim mbi kërkesën e banorëve të fshatit Shkabaj”. Po ashtu propozoi që kjo pikë të jetë pikë e dytë në rendin e ditës.

Jeta Rafuna: - propozoi që pika: “Propozim-vendimi për kompensim vjetor financiar për punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës, të jetë pika e dytë, pas miratimit të ekstraktit të procesverbalit.

Faqe Inga 5

Xhavit Ahmeti: - tha se e përkrahu propozimin e z. Sveçla që në rend të ditës të hyjë pika: “Diskutim mbi kërkesën e banorëve të fshatit Shkabaj”.

Leutrim Retkoceri: - propozoi që pika: “Diskutim mbi kërkesat e banorëve të fshatit Shkabaj”, të jetë pika e pestë në rend të ditës.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet si në vijim:

Kryesuesi konstatoi se më 40 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Zogaj, që pika e propozuar të hyjë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 3 abstenime, u miratua propozimi i z. Sveçla, që pika e propozuar hyjë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për dhe 20 kundër, nuk u miratua propozimi i z. Sveçlës që pika: “Diskutim mbi kërkesat e banorëve të fshatit Shkabaj” të mbetet pika e dytë e rendit të ditës.

Bahri Gashi: - ngriti shqetësim rreth mungesës së materialit për pikën: Diskutim mbi kërkesat e banorëve të fshatit Shkabaj”, i cili tha se përderisa nuk kemi material, do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhet për më vonë, për në njërin nga mledhjet e radhës së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 13 kundër dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i z. Retkocerit që pika: “Diskutim mbi kërkesat e banorëve të fshatit Shkabaj”, të jetë pika e pestë në rend të ditës.

Me ndryshimet dhe propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se, më 35 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së tetë dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit;**
- 2. Propozim - vendimi për kompensimin vjetor financiar për punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës;**
- 3. Propozim - vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për kompensimin ditor për financimin e ushqimit për të punësuarit në Komunën e Prishtinës;**
- 4. Propozim - vendimi për subvencionimin e KRM ”Pastrimit” SH.A;**
- 5. Diskutim mbi kërkesën e banorëve të fshatit Shkabaj;**
- 6. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik deri më 30 shtator 2024 (TM3);**
- 7. Propozim - vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;**
- 8. Propozim - vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;**

Faqe2nga5

9. Formimi i Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e aktvendimit mbi eksproprijimin me nr. 07 nr. 465-25/85, të dt. 8 korrik 1985;
10. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025 në Prishtinë;
11. Raport vjetor i punës për vitin 2023 lidhur me punën e Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike "Termokos", S.H.A;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së tetë dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të seancës së tetë dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit.

Pika e dytë

Propozim - vendimi për kompensimin vjetor financiar për punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi tha se, si iniciues për propozimin e kësaj pike, kam qenë unë, kështu që duke e pasur parasysh se punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës asnjëherë më parë nuk kanë mundur t'i gëzojnë të drejtat e tyre që derivojnë nga ligji i veçantë që e trajton Komunën, në mënyrë të veçantë si në aspektin ligjor dhe rregullativ nga komunitat tjera të Republikës së Kosovës. Duke respektuar Ligjin për Kryeqytetin, në veçanti neni 17, paragrafi 4, neni 19, financimi i kryeqytetit, decidivisht kërkojmë kompensim vjetor për punëtorët e saj në vlerë prej 1370 euro bruto, ose 1200 euro neto për secilin punëtor të administratës të Komunës së Prishtinës.

Gëzim Sveçla: - tha se ne si Lëvizje Vetëvendosje e mbështesim këtë propozim, kështu që ne që një kohë të gjatë kemi kërkuar që kjo të arrihet përmes një rruge të drejtë ligjore. Për këtë propozim na ka ardhur një bazë ligjore e trajtuar nga ana e përfaqësuesve të sindikatës të cilën ne po besojmë që është e duhur, por paraprakisht është dashtë me ditë edhe sindikata, po edhe asambleja e pranishme e sidomos përfaqësuesit e partive në pushtet që e kanë pasur mundësinë ideale që këtë pjesë ta trajtojnë me buxhetin, por nuk është propozuar fare që të jetë një kod i veçantë buxhetor që do ta trajtonte këtë çështje. E përkrahim këtë propozim, duke i larguar nga propozimi të zgjedhurit në këtë rast asamblistët, sepse vlerësojmë që nuk është e drejtë që ne si asamblistë vetes me i nda para e njëkohësisht edhe të emëruarit politikë, të emëruarit politikë nëpër kabinete e drejtori dhe çdo i emëruar politik, i cili nuk është në mardhënie pune të rregullt me kontratë në Komunën e Prishtinës.

Milazim Vitia: - tha se më vjen mirë që më në fund kjo pikë ka një mbështetje ligjore, që këta punëtorë të kompensohen, sepse e dimë gjendjen e tyre financiare qysh e kanë, prandaj ne si grup normal që e përkrahim që kjo listë të ekzekutohet në tërësi.

Leutrim Retkoceri: - tha se sa i përket propozimeve që u bënë, ka bazë të mjaftueshme ligjore, për shkak se mbështetet në Ligjin për Kryeqytetin, një ligj i cili nuk është duke u shfrytëzuar mjaftueshëm nga ekzekutivi i Komunës për t'i shërbyer Kryeqytetit e qytetarëve nga përparësitë që jep ky ligj. Granti që garanton ligji ku është i mbështetur dhe kjo kërkesë për kompensim, besojmë se do ta mundësojë realizimin e këtij kompensimi. Grupi i samblistëve të Partisë Demokratike mbështet

dhe voton kompensimin vjetor financiar për punëtorët e administratës të Komunës së Kryeqytetit për shujtën prej 5 euro, gjithashtu edhe rregulloren që është pikë e rendit të ditës e që do të trajtohet pas këtij propozim-vendimi.

Bahri Gashi: - tha se kjo është një përkrahje e mirë për ata punëtorë të administratës, kështu që mendoj që kushdo që e ka përgjegjësinë kryesore për vitin e ardhshëm me u ul dhe me menduar se qysh këto shujta me kaluar në mënyrë të rregullt e jo me u bë temë politike e jona këtu. Atyre ju takon me të drejtë dhe ne këtë propozim-vendim e përkrahim për miratim.

Gëzim Mehmeti: - tha se propozimi jonë, konkretisht i propozuesit është i qartë dhe i drejtë, të miratojmë një kompensim financiar i cili bazohet në ligje dhe nuk është në kundërshtim me ligjet e Republikës së Kosovës për të gjithë punonjësit e administratës si masë mbështetëse për të përballuar rritjen e çmimit dhe inflacionit. Kompensimi nuk është vetëm një gjest vitaliteti me ta, por një domosdoshmëri për të ruajtur mirëqenien e punonjësve për të shmangur pasojat që mund të kenë ata dhe familjet e tyre nga gjendja ekonomike aktuale.

Endrit Zabërgja: - tha se ne kemi tentuar edhe në të kaluarën për t'i dhënë një zgjidhje ligjore dhe shumë mirë që kemi ardhur deri te kjo pikë, në mënyrë që punëtorët e Komunës, të cilët vazhdimisht me një zell dhe devotshmëri mundohen që t'i kryejnë të gjitha ato shërbime dhe detyra të qytetarëve, të ndihen që kanë një kujdes nga Kuvendi komunal në këtë rast nga asamblistët dhe nga organi më i lartë i Komunës, andaj patjetër e mbështesim këtë propozim-vendim për miratim.

Arianit Beqiri: - tha se ka punëtorë të cilët janë në kompani private dhe të cilët punojnë në Komunë, kjo kategori është e përjashtuar nga ky propozim-vendim, kështu që do të ishte mirë që ne të mendojmë për këta punëtorë, siç janë punëtorët e sigurimit privat, se qysh mundemi me i ndihmuar, të paktën për festat e fundvitit.

Leutrim Retkoceri: - tha se a munden me u përfshi punëtorët që punojnë në pastrim, qoftë edhe trupat e sigurimit fizikë në këtë objekt, a ju takon dhe a ka mundësi me u përfshi në këtë propozim-vendim.

Kryesuesi: - tha se punëtorët e kompanive private të cilët punojnë në këtë objekt, nuk ka mundësi që edhe ata të përfshihen në këtë propozim-vendim.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Sveçla, i cili propozoi që asamblistët dhe të emëruarit politikë, si dhe këshillëtarët e kryetarit, të mos jenë pjesë e mbështetjes së kompensimit financiar.

Kryesuesi konstatoi se më 12 vota për, 21 kundër dhe 6 abstenime, nuk u miratua propozimi i z. Sveçla.

Kryesuesi konstatoi se më 43 vota për, u miratua Vendimi për kompensimin vjetor financiar për punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës.

Pika e tretë

Propozim - vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për kompensimin ditor për financimin e ushqimit për të punësuarit në Komunën e Prishtinës.

Kryesuesi tha se unë si propozues i kësaj pike, falënderoj të gjitha grupet parlamentare, të cilat u pajtuan me këtë propozim në mbledhjen e KPF-së, prandaj kërkoi që ky propozim-vendim të dalë në

diskutim publik, pasi që na obligon Rregullorja e punës së Kuvendit dhe Udhëzimi administrativ me numër 04/2023 për administratë të hapur në Komunë sipas nenit 19 për konsultime publike.

Kryesuesi konstatoi se më 36 vota për, u miratua Vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për kompensimin ditor për financimin e ushqimit për të punësuarit në Komunën e Prishtinës.

Pas një pauze prej një ore, me të filluar vazhdimi i mbledhjes, në mungesë të kuorumit kryesuesi e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina**



Faqe5nga5